



2021





**RAPORTI PËRMBLEDHËS  
I AKTIVITETEVE  
TË PLATFORMËS CIVIKOS  
2021**



# PËRMBAJTJA

|    |                                                                                                                                                 |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 6  | LISTA E AKRONIMEVE                                                                                                                              |
| 7  | HYRJE                                                                                                                                           |
| 9  | 1.PUNA E CIVIKOS NË PËRBALLJE ME PANDEMINË COVID-19                                                                                             |
| 9  | 1.1 Bashkëpunimi me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Odën Ekonomike të Kosovës                                                       |
| 9  | 1.1.1 Platforma Realitet i Ri                                                                                                                   |
| 10 | 1.1.2 Shnet e Scan dhe trajnimet për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës                                                                   |
| 11 | 1.1.3 Rekomandimet për institucionet e Kosovës dhe promovimi i vaksinimit masiv                                                                 |
| 12 | 1.2 Projekti dhe kampanja #NiseMuhabetin                                                                                                        |
| 14 | 2. SHËRBIMET E SEKRETARIATIT TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR ORGANIZATAT ANËTARE                                                                      |
| 14 | 2.1 Sesion informues: Raportimi vjetor i OJQ-ve në ATK dhe obligimet e tjera tatimore                                                           |
| 15 | 2.2 Të gjeturat e raportit të BE-së për Kosovën 2021                                                                                            |
| 16 | 3. BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI                                                                                                         |
| 16 | 3.1 Takime të rregullta me Zyrën për Qeverisje të Mirë                                                                                          |
| 16 | 3.2 Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri                                                                                            |
| 16 | 3.2.1 Objektiva 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje                                                                  |
| 17 | 3.2.2 Objektiva 2: Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik |
| 17 | 3.2.3 Objektiva 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike                           |
| 19 | 3.2.4 Objektiva 4: Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik                                                                       |
| 20 | 3.2.5 Takimi përmbyllës i Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri                                                                     |
| 20 | 3.2.6 Korniza për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021 - 2025                         |

|    |                                                                                                                        |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 21 | 4. AVOKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PUBLIKE                                                                   |
| 21 | 4.1 Skema e granteve për monitorim të prokurimit publik në nivel lokal                                                 |
| 21 | 4.2 Lehtësimi i përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik                              |
| 22 | 4.3 Bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi                                                                |
| 23 | 4.4 Memorandum i Mirëkuptimit në mes të CiviKos, Këshillit të Mediave të Shkruara dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës |
| 23 | 4.5 Panel informues rreth formalizimit të punëtorëve dhe evazionit fiskal në Kosovë                                    |
| 24 | 5. AKTIVITETE DHE BASHKËPUNIME TË TJERA                                                                                |
| 24 | 5.1 Aktivitetet në kuadër të USAID TEAM                                                                                |
| 24 | 5.1.1 Punëtori mbi mësimin e aplikueshëm në monitorim të prokurimit publik                                             |
| 25 | 5.1.2 Infografikat e publikuara nga organizatat përfituese                                                             |
| 26 | 5.1.3 Ngritja e kapaciteteve të organizatave nga rajoni i veriut në monitorim të prokurimit publik                     |
| 26 | 5.1.4 Platforma Monitoro-Raporto                                                                                       |
| 27 | 5.1.5 Njohja e kompetencës në monitorim të prokurimit publik                                                           |
| 28 | 5.2 Adresimi i sfidave dhe problemeve të OJQ-ve me bankat komerciale në Kosovë                                         |
| 28 | 5.3 Ngritja e kapaciteteve të organizatave lokale mbi avokimin e të drejtave të njeriut                                |
| 28 | 5.3.1 Punëtoritë për të drejtat e njeriut                                                                              |
| 29 | 5.3.2 Krijimi i Human Rights Hub                                                                                       |
| 29 | 5.3.3 Konferenca ‘Roli i Shoqërisë Civile në Avokim për të Drejtat e Njeriut’                                          |
| 30 | 5.4 Bashkëpunimi i CiviKos me International Visegrad Fund                                                              |
| 31 | 5.5 Aktivitetet në kuadër të Konferencës për të Ardhmen e Evropës (CoFoE)                                              |
| 31 | 5.5.1 Fokus grupi                                                                                                      |
| 31 | 5.5.2 Konferenca                                                                                                       |
| 32 | 5.6 Diskutim me Simon Panek, themelues i People in Need                                                                |

# LISTA E AKRONIMEVE

|         |                                                             |
|---------|-------------------------------------------------------------|
| CiviKos | Platforma CiviKos                                           |
| OSHC    | Organizatë e Shoqërisë Civile                               |
| KCSF    | Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile                       |
| ZQM     | Zyra për Qeverisje të Mirë                                  |
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit                                        |
| UNKT    | United Nation Kosovo Team                                   |
| MAPL    | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                |
| USAID   | The United States Agency for International Development      |
| TEAM    | Transparent Effective and Accountable Municipalities        |
| UNKT    | UN Kosovo Team                                              |
| OEK     | Oda Ekonomike e Kosovës                                     |
| OBSH    | Organizata Botërore e Shëndetësisë                          |
| ATK     | Administratën Tatimore të Kosovës                           |
| BE      | Bashkimi Evropian                                           |
| ZQM     | Zyra për Qeverisje të Mirë                                  |
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit                                        |
| TACSO   | Technical Assistance for Civil Society                      |
| MCC     | Millenium Challenge Cooperation                             |
| OGP     | Open Government Partnership                                 |
| PQH     | Partneriteti për Qeverisje të Hapur                         |
| KPK     | Këshilli Prokurorial i Kosovës                              |
| ECNL    | European Centre for Not-for-Profit Law                      |
| SIDA    | Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| IDSCS   | Instituti për Demokraci 'Societas Civilis'                  |
| V4      | International Visegrad Fund                                 |
| COFOE   | Conference for Future of Europe                             |
| FES     | Friedrich Ebert Stiftung                                    |
| PIN     | People in Need                                              |

# HYRJE

Puna e Platformës CiviKos gjatë vitit 2021 është fokusuar në zbatimin e aktiviteteve në funksion të ngritjes së bashkëpunimit me organizatat anëtare, promovimin e punës së organizatave anëtare, si dhe rrjetëzimin në mes të organizatave me veprim lokal me autoritetet publike.

Përveç komponentës së anëtarësisë, CiviKos në bashkëpunim ka punuar në fuqizimin e rolit të Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Ky angazhim i CiviKos ka pasur për qëllim që të revitalizojë Këshillin duke synuar që të dinamizohet puna e këtij mekanizmi pas ndikimit që kishte pandemia COVID-19.

Gjatë vitit 2021, CiviKos ka bërë edhe një hap tutje duke iniciuar bashkëpunimin me sektorin privat përmes partneritetit të ngushtë me Odën Ekonomike të Kosovës. Ky bashkëpunim ka zgjeruar edhe më tej misionin e CiviKos me qëllim të diversifikimit të partnerëve duke sjellë në skenë hisedarë të ri dhe duke shërbyer si urë në mes të sektorit publik dhe privat.

Të gjitha aktivitetet e mëposhtme reflektojnë përpjekjet që sekretariati ka bërë për t'i shërbyer organizatave anëtare, por edhe për të krijuar një ambient sa më të favorshëm për funksionimin e shoqërisë civile në Kosovë – kjo e fundit e realizuar në bashkëpunim të ngushtë me organizatat anëtare, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile pjesë e Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

CiviKos falënderon të gjitha organizatat anëtare për besimin dhe bashkëpunimin, si dhe iu uron mirëseardhje organizatave të reja që janë bashkuar me ne, për të forcuar edhe më tej këtë platformë. Po ashtu një falënderim edhe për autoritetet publike që kanë treguar nivel solid të bashkëpunimit – sidomos Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM). CiviKos falënderon donatorët që kanë besuar dhe mbështetur punën tonë, duke shpresuar që ky bashkëpunim të na përcjellë edhe në vitet në vazhdim.





# 1. PUNA E CIVIKOS NË PËRBALLJE ME PANDEMINË COVID-19

## 1.1 Bashkëpunimi me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Odën Ekonomike të Kosovës

Platforma CiviKos, qysh në shpalljen e virusit si pandemi, kishte vënë në funksion tërë ekipin në përkrahje të iniciativave të shoqërisë civile në përballje me pandeminë, si dhe kishte dizajnuar fushata vetëdijesimi në kohën kur shpërndarja e informatave kredibile për mbrojtje ndaj virusit ishte kritike. Pas përvojës dhe bashkëpunimit që rezultuan nga fushata #VendoseMaskën, aktivitetet e CiviKos në lidhje me COVID-19 u zgjeruan edhe me sektorë e hisedarë të tjerë. Viti 2021 filloi me një partneritet me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UN Kosovo Team - UNKT) dhe Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), që kishte qëllim kryesor krijimin e një platforme të disa hisedarëve (sektorit privat, shoqërisë civile vendore dhe organizatave ndërkombëtare), e para e llojit të saj për bashkëpunim shumëpalësh për menaxhimin e pandemisë.

### 1.1.1 Platforma Realitet i Ri

Platforma e bashkëpunimit shumëpalësh e titulluar Realitet i Ri, erdhi si përgjigje ndaj nevojës së shpërndarjes dhe thjeshtimit të informatave të besueshme e të përditësuara në lidhje me masat kundër COVID-19, me fokus shëndetin dhe sigurinë në ambientet e punës të sektorit privat. Përtej këtyre informatave thelbësore për pandeminë, platforma ofronte në një vend të vetëm të gjitha publikimet dhe hulumtimet e bëra në lidhje me pandeminë dhe sektorin privat, informatat dhe udhëzimet për ndihma financiare, informatat nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) për informim të drejt kundër miteve për COVID-19, promovimin e bizneseve që janë trajnuar mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punë në lidhje me virusin, dhe informata tjera relevante dhe të përditësuara. Platforma u lansua në maj 2021.



Foto 1: Partnerët e projektit Realitet i Ri në lansimin e platformës

Për Platformën Civikos, ky bashkëpunim ishte hapi i parë i formalizmit të bashkëpunimit me sektorin privat. Pjesë e projektit ishte edhe fushata e vetëdijesimit **të qytetarëve në përputhje me praktikën më të mira higjienike dhe të distancimit social**. Për këtë qëllim, **u zhvilluan video** vetëdijesuese dhe infografikë **për rreziqet** e COVID-19 si dhe masat minimale mbrojtëse që duhen marrë për sigurinë dhe shëndetin e të gjithëve. Këto video dhe infografikë pastaj u shpërndanë dhe u promovuan në kanale të ndryshme të komunikimit. Promovimi i partneritetit dhe fushatës ishte pjesë integrale e planit të veprimit deri në përfundim të projektit, ndaj i njëjti brendim dhe material është shfrytëzuar dhe modifikuar edhe për festivalin DokuFest, pasi mbështetësit e projektit – UNKT, ishin të angazhuar me aspektet e shëndetit publik si vazhdim i punës së tyre gjatë pandemisë.



Foto 2: Brendimi i Platformës Realitet i Ri

### 1.1.2 Shnet e Scan dhe trajnimet për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës

Në kuadër të projektit Realitet i Ri, u dizajnuan edhe produktet me QR kodin Shnet e Scan që lidhte përdoruesit direkt me platformën dhe informacionet që ishin të qasshme në të. Aksionet e shpërndarjes së produkteve Shnet e Scan u bënë në bashkëpunim me Shoqatën e Gastronomëve të Kosovës në bizneset anëtare të tyre në të gjitha rajonet e vendit. Më tutje, gjatë muajit qershor u organizuan trajnime hibride për bizneset e gastronomisë mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, me fokus masat dhe udhëzuesit kundër COVID-19. Për zhvillimin e modulit dhe mbajtjen e trajnimeve ishte angazhuar trajneri lokal i licencuar për këtë fushë, z. Ruzhdi Feka. Partnerët nga Shoqata e Gastronomëve së bashku me trajnerin zhvilluan gjithashtu edhe vizita në terren për udhëzimin e drejt të bizneseve për përputhjen e veprimtarisë së tyre me masat e fundit, promovimin e platformës Realitet i Ri dhe shpërndarjen e produkteve Shnet e Scan.

Foto 3: Foto të produkteve Shnet e Scan






Foto 4: Trajnimi mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës me bizneset e gastronomisë

### 1.1.3 Rekomandimet për institucionet e Kosovës dhe promovimi i vaksinimit masiv

Gjatë muajit gusht, Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Platforma Civikos mbajtën një konferencë të përbashkët për media, me ç'rast u prezantuan rekomandimet e përbashkëta për të promovuar vaksinimin masiv në Kosovë. Rekomandimet që u përpiluan nga konsultimet me përfaqësues biznesesh dhe partnerë nga shoqëria civile gjatë kohës që po zhvilloheshin aktivitetet e këtij projekti ishin:

- Heqja e burokracisë në rezervimin e termineve për qasje më të lehtë e të thjeshtëzuar të qytetarëve;
- Mundësimi i vaksinimit në qendrën më të afërt, pa marrë parasysh vendbanimin e regjistruar zyrtarisht;
- Vaksinimi përmes ekipeve mobile nëpër biznese, pasi që aktiviteti i tyre ekonomik po pengohet nga oraret e limituara e ndërkohë rrezikshmëria nga kontakti me njerëz duke qenë të pa vaksinuar po rritet;
- Ekipe mobile të vaksinimit për vendet më rurale e të izoluara, e sidomos ato që banohen kryesisht nga komunitetet e kanë përgjithësisht më pak qasje në informata të sakta;
- Riorganizim i resurseve të punëtorëve të shëndetësisë në atë mënyrë që oraret e vaksinimeve të vazhdojnë edhe në vikend. Kjo sidomos e rëndësishme duke ditur që shumë qytetarë e kanë të pamundur të vaksinohen gjatë ditëve të punës, aq më tepër nëse punojnë në qytete të tjera larg vendbanimit të tyre të regjistruar;
- Vaksinimi në sheshet e qendrave kryesore në vend për të arritur shifra që përkojnë me një vaksinim masiv të vendit;
- Bashkëpunimi me shtete të tjera për t'u siguruar që pasaporta jonë e vaksinimit do të pranohet si dëshmi nga ato shtete për të mënjnauar pengesat eventuale në lëvizjen e lirë.



Foto 5: Konferenca për media në lidhje me rekomandimet e përbashkëta



## 1.2 Projekti dhe kampanja #NiseMuhabetin

Puna e CiviKos në përballje me pandeminë vazhdoi me fushatën tjetër vetëdijesuese, këtë herë e fokusuar shumë në promovimin dhe rritjen e vaksinimit. Projekti dhe kampanja #NiseMuhabetin, e zhvilluar dhe zbatuar nga Platforma CiviKos në periudhën shtator 2021 – mars 2022, u mbështet financiarisht nga SlovakAid.



Foto 6: Stikerat e kampanjës #NiseMuhabetin

Projekti kishte target sidomos grupet e të rinjve dhe grave, e të cilat tregonin ngecje në rritjen e vaksinimit nga qarkullimi i miteve dhe informatave jokredibile për ndikimin e vaksinës në shëndetin riproduktiv. Ndaj, pjesë e aktiviteteve dhe kampanjës ishte dizajnimi i broshurave kundër miteve të vaksinës, videove vetëdijesuese me infektologun dhe artist që ndiqen nga të rinjtë, si dhe stikerave dhe materialeve të tjera që promovonin vaksinimin. Sidoqoftë, aktivitetet kryesore të këtij projekti ishin vizitat në terren me mjekun, të organizuara në bashkëpunim me organizatat anëtare të qyteteve përkatëse.

Gjatë këtyre vizitave, pjesëmarrësit kishin mundësi të ndiqnin një ligjëratë të detajuar se si vakcina COVID-19 është prodhuar, si pranohet nga organizmi ynë, dhe rëndësia e shfrytëzimit të saj si mjet i vetëm për të luftuar dhe përfunduar pandeminë. Kjo vizitë në format të tillë ofronte edhe mundësinë që secili pjesëmarrës të adresonte shqetësimet, rezervimet dhe pyetjet e tyre drejtpërdrejt me profesionistët e fushës. Në fakt, ky format ishte pritur aq mirë, saqë organizatat tona partnere lokale



Foto 7: Takimi me mjekun në Dragash



Foto 8: Takimi me mjekun në Mitrovicë



Foto 9: Takimi me mjekun në Gjakovë



Foto 10: Takimi me mjekun në Klinë

që kanë mundësuar implementimin e tyre kishin pranuar kërkesa për organizime të tjera të tilla nga njerëz të komunës së tyre të interesuar për informim të tillë. Duke qenë se projekti ishte i limituar në kohë dhe financa, vetëm disa qytete ishin targetuar për këto vizita. Gjegjësisht, qytetet target të projektit ishin: Mitrovica, Klina, Gjakova, Dragashi dhe Gjilani.



*Foto 11 dhe 12: Takimi me mjekun në Gjilan*

Si aktivitet përmbyllës i këtij projekti, u organizua një panel diskutimi që mbledhi shumë hisedarë dhe partnerë të CiviKos. Ky diskutim zgjerohej në reflektimin mbi dy vjet të pandemisë nga panelistët, ndarjen e përvojave të sektorit të tyre përkatës, si dhe dhënien e rekomandimeve të tyre për vazhdimin e një menaxhim më të mirë të pandemisë. Ngjarja u zhvillua në formatin hibrid, me partnerë dhe anëtarë të Platformës CiviKos si pjesëmarrës.

## 2. SHËRBIMET E SEKRETARIATIT TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR ORGANIZATAT ANËTARE

CiviKos ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve informuese për organizatat anëtare. Gjatë vitit 2021 janë dërguar gjithsej 144 buletine informuese me informata relevante për shoqërinë civile, si:

- Informata për grante;
- Bashkëpunime të ndryshme me organizata lokale dhe ndërkombëtare;
- Trajnime dhe seminare të ndryshme;
- Informata rreth bashkëpunimit shoqëri civile-autoritete publike.

### 2.1 Sesion informues: Raportimi vjetor i OJQ-ve në ATK dhe obligimet e tjera tatimore

CiviKos në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) kanë organizuar një sesion informues për OJQ-të mbi detyrimet tatimore për organizatat e shoqërisë civile. Ky takim është mbajtur virtualisht përmes platformës Zoom, me rreth 100 pjesëmarrës nga organizatat e shoqërisë civile dhe ligjërues z.Sami Salihu nga ATK. CiviKos po ashtu kishte ofruar përkthim në gjuhën serbe për organizatat e udhëhequra nga komuniteti serb që jetojnë në Kosovë.

The screenshot shows a Zoom meeting in progress. At the top, there are video thumbnails of participants: Hoxhë Mehmeti, CiviKos - Fleta B..., and Bekim Bytyqi. The main screen displays a presentation slide with the title "Në të ardhurat bruto nuk përfshihen:" (In gross income is not included:). The slide lists three items:

- Kompenzimi i shpenzimeve reale të udhëtimit të biznesit ku përfshihen transporti, ushqimi dhe fjetja për udhëtime zyrtare;
- Transporti – 16 cent për/ km brenda Kosovës, jashtë Kosovës nuk ka limit por vetëm bileta, e gatshme për inspektim;
- Shujta – 15€ brenda dite dhe 25€ nëse nata kalohet në Kosovë, ndërsa për udhëtime jashtë Kosovës, konform Udhezuesit nga Ministria e Financave;
- Fjetja - brenda Kosovës 50€, ndërsa jashtë Kosovës bazuar në Udhezuesin nga Ministria e Financave;

At the bottom left of the slide is the logo of the Tax Administration of Kosovo, with the text "Administrata Tatimore e Kosovës", "Porekska Administracija Kosovo", and "Tax Administration of Kosovo". On the right side of the Zoom window, a list of participants is visible, including names like Oshinor - Fleta Salihu, Sami Salihu, and others.

Foto 13: Sesion informues përmes Zoom



## 2.2 Të gjeturat e raportit të BE-së për Kosovën 2021

Sekretariati i CiviKos ka përmbledhur në një infografikë të veçantë të gjeturat e raportit të Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën, respektivisht mesazhet kryesore për shoqërinë civile.




Foto 14: Infografika “Mesazhet kryesore të raportit të progresit për SHC, 2021”

## 3. BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI

### 3.1 Takime të rregullta me Zyrën për Qeverisje të Mirë

CiviKos së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM), kanë vazhduar udhëheqjen e procesin e bashkëpunimit Shoqëri Civile - Qeveri. Respektivisht, zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019 - 2023, duke u koordinuar me takime dhe përcjellje të rregullta të informatave.

### 3.2 Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri është mekanizmi kryesor që koordinon procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Këshilli ka gjithsej 29 anëtarë, 15 anëtarë nga të cilët janë të zgjedhur në mënyrë demokratike nga vet organizatat e shoqërisë civile përmes procesit të votimit nga Platforma CiviKos dhe 14 anëtarë të tjerë janë të emëruar drejtpërdrejt nga Qeveria.

Pas largimit vullnetar të tre anëtarëve të shoqërisë civile nga Këshilli, Sekretariati CiviKos ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të shoqërisë civile në Këshill.

Tre anëtarët e rinj të përzgjedhur në Këshill janë:

- Qendrim Hoxha nga OJQ Leadership Development Association Balkan;
- Vlorian Molliqaj nga OJQ Action for Mothers and Children; dhe
- Rinor Krasniqi nga OJQ Jeta Rinore.



Foto 15: Takim me Zyrën për Qeverisje të Mirë

#### 3.2.1 Objektiva 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje

CiviKos, në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë organizuan takime të rregullta përgjatë vitit me anëtarë të grupit punues të objektives së parë të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Ky grup punues është koordinuar nga z. Dren Puka nga KCSF.





Foto 16: Takim me grupin punues për Objektiven 1 të Strategjisë

### **3.2.2 Objektiva 2: Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik**

Në takimin e grupit të dytë punues të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri, u diskutuan të arriturat dhe sfidat në zbatim në lidhje me këtë objektivë strategjike dhe plani për realizimin e aktiviteteve të mbetura. Këto takime u koordinuan nga z. Art Jashari.






Foto 17: Takim me grupin punues për Objektiven 2 të Strategjisë

### **3.2.3 Objektiva 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike**



Foto 18: Takim me grupin punues për Objektiven 3 të Strategjisë

Grupi i tretë punues, me koordinatore znj. Adile Shaqiri, kanë mbajtur takime të rregullta për zbatim të planit të objektivës strategjike të tretë. Në përkrahje të punës së këtij grupi, CiviKos ka përgatitur disa infografika informuese rreth kontraktimit të shërbimeve në Kosovë, mundësive dhe modeleve.





### 3.2.4 Objektiva 4: Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik

Takimet e grupit të katërt të Strategjisë Qeveritare u mbajtën nën koordinimin e znj. Abetare Gojani nga IPKO Foundation. Në këto takime u vlerësuan të arriturat dhe sfidat në zbatim të këtij objekti strategjik si dhe plani për zbatim të aktiviteteve të mbetura.



*Foto 23: Takimi me grupin punues për Objektiven 4 të Strategjisë Qeveritare*



*Foto 24: Foto gjatë takimit me koordinatorët e ekipeve të punës së Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri dhe TACSO në Kosovë*



*Foto 25: Foto gjatë takimit me koordinatorët e ekipeve të punës së Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri dhe TACSO në Kosovë*

### *3.2.5 Takimi përmbyllës i Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri*

Me 23 dhjetor u mbajt takimi përmbyllës i Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. Gjatë takimit grupet punuese prezantuan të arriturat dhe sfidat për katër objektivat e strategjisë si dhe planet për zbatim të plotë të këtyre objektivave. Pandemia COVID-19 si dhe ndërrimet e shpeshta të qeverive në Kosovë u konsideruan si sfidat kryesore të zbatimit të strategjisë.



*Foto 26: Takimi përmbyllës i Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri*

### *3.2.6 Korniza për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021 - 2025*

Më 5 nëntor 2021, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në një tryezë të përbashkët me shoqërinë civile dhe strukturat koordinuese të konsultimeve me publikun në nivel qendror e lokal, lansoi 'Kornizën për Përmirësimin e Zbatimit të Standardeve Minimale për Konsultimet me Publikun për Periudhën 2021 – 2025'. Nga kjo kornizë janë nxjerrë rekomandime se si institucionet duhet të përmirësojnë zbatimin e standardeve minimale për gjithëpërfshirje të publikut në punën e saj. Përgatitja dhe publikimi i kësaj kornize u mundësua me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

## 4. AVOKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PUBLIKE

### 4.1 Skema e granteve për monitorim të prokurimit publik në nivel lokal

Më datë 19 janar, në kuadër të projektit të aktivitetit të USAID për Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhëse, CiviKos u takua me përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Në këtë takim u bisedua rreth mundësisë së krijimit të një skeme të granteve për organizatat e shoqërisë civile që e monitorojnë prokurimin publik në nivel lokal. Krijimi i kësaj skeme ka një rëndësi të veçantë për organizatat lokale, pasi do të siguronte qëndrueshmëri për to edhe pas përfundimit të aktivitetit të USAID.



Foto 27: Takimi me përfaqësues të MAPL-së

### 4.2 Lehtësimi i përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik

CiviKos ka vazhduar me takime avokuese me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal edhe për çështje të tjera relevante për shoqërinë civile. Në prill 2021, në një takim të përbashkët me MAPL, CiviKos kishte trajtuar çështjen e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në trupat publik që operojnë në kuadër të MAP.



Foto 28: Takime në mes të CiviKos dhe MAPL-së

Në korrik 2021, Sekretariati i CiviKos me kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile në Komitetin e Auditimit, duke shfrytëzuar procedurat e Civikos sipas rregullores së punës. Komiteti i Auditimit, është organ i pavarur



këshillëdhënës për udhëheqësin e MAPL-së dhe mbështetës për auditorët e brendshëm themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Kapitulli III, neni 20.

Në gusht 2021 me kërkesë të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, CiviKos ka lehtësuar përzgjedhjen e përfaqësuesit të shoqërisë civile në Panelin Rekrutues të Anëtarëve të Ekipit Vendor për Zhvillimin e Marrëveshjes Compact. Ky është një ekip i formuar nga tetë specialistë të fushave të ndryshme dhe ka për qëllim lehtësimin e procedurave për arritjen e një marrëveshje Compact mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Millenium Challenge Corporation (MCC). ‘Compact’ është një nga dy grantet që dhurohen nga MCC për shtetet në zhvillim. Ky grant fitohet në momentin e arritjes së një marrëveshje Compact, marrëveshje kjo e cila përcakton projektet në të cilat do të investohet shuma e fituar, obligimet e të dy palëve drejt realizimit të këtyre projekteve si dhe obligimet që palët kanë ndaj njëra tjetrës.

Gjithashtu në këtë muaj, CiviKos me kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtarëve të shoqërisë civile në Komitetin Nacional Koordinues të Open Government Partnership (OGP apo Partneriteti për Qeverisje të Hapur – PQH) në Kosovë. OGP është një mekanizëm ndërkombëtar i cili për synim ka promovimin e mirëqeverisjes, qeverisjes së hapur dhe transparente, qeverisjen elektronike, llogaridhënien, luftën kundër korrupsion dhe ngritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Në këtë kontekst, për Republikën e Kosovës është shumë e rëndësishme përgatitja dhe anëtarësimi në këtë organizatë. Për t’u anëtarësuar, duhet që Komiteti Nacional Koordinues të hartojë Planin Nacional të Veprimit 2022 - 2024. Komiteti Nacional Koordinues përbëhet nga institucionet publike, shoqëria civile (me shumicë anëtarësh), sektori i biznesit, si dhe organizata dhe institucione relevante vendore e ndërkombëtare.

#### *4.3 Bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi*

CiviKos, së bashku me organizatat anëtare INPO, EC Ma Ndryshe, KCIC, YMCA Kosovo, Community Building Mitrovica (CBM), dhe Syri Vizionit, kanë lehtësuar procesin e organizimit të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Qasje Universale në Informacione. Iniciativa është titulluar ‘Tash më Lehtë’, e cila është shënuar me aktivitete në të gjitha komunat e Kosovës.

Gjatë muajit gusht, CiviKos ka vazhduar takimet me Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, znj. Krenare Sogojeva Dermaku, për të thelluar bashkëpunimin me qëllim të promovimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, trajtimin e mosfrimit të qasjes për OJQ-të në informata publike nga institucionet publike, dhe krijimit të një sistemi të monitorimit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.



*Foto 29: Takimi me Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi*



#### *4.4 Memorandum i Mirëkuptimit në mes të CiviKos, Këshillit të Mediave të Shkruara dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës*

Më 28 Qershor, CiviKos dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nënshkruan një Memorandum të Mirëkuptimit me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), me qëllim të krijimit të procedurave standarde për shoqërinë civile dhe mediat për të dorëzuar raste tek Prokuroria e Shtetit.

Memorandumi, që është përgatitur me ndihmën e aktivitetit të USAID për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, krijon mundësinë për të ndërtuar procedurë standarde për dorëzim të rasteve të identifikuar dhe angazhimin e KPK-së për të ofruar informata kthyesë që t'iu mundësoj organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të përcjellin rastet e dorëzuara.



*Foto 30: Momente nga nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të CiviKos, Këshillit të Mediave të Shkruara dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës*

#### *4.5 Panel informues rreth formalizimit të punësorëve dhe evazionit fiskal në Kosovë*

Administrata Tatimore e Kosovës në bashkëpunim me Platforma Civikos, kanë organizuar panel informues rreth formalizimit të punësorëve dhe evazionit fiskal në kuadër të projektit të fundit të ATK-së për punësimin jo-formal. Ky panel diskutimi kontribuoi në ngritjen e vetëdijes, shtrirjen e debatit në këtë temë, dhe përmirësimin e situatës përmes bashkëpunimit shumëpalësh. Ky diskutim është udhëhequr nga znj. Donika Emin, Drejtore e Platforma CiviKos.

## 5. AKTIVITETE DHE BASHKËPUNIME TË TJERA

### 5.1 Aktivitetet në kuadër të USAID TEAM

#### 5.1.1 Punëtori mbi mësimin e aplikueshëm në monitorim të prokurimit publik

Në kuadër të aktivitetit të USAID për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM), gjatë vitit 2021 janë ofruar punëtori mbi mësimin e aplikueshëm për mbështetje të organizatave lokale në monitorim të aktiviteteve të prokurimit publik. Ekspertët e angazhuar nga CiviKos kanë ndihmuar organizatat lokale përgjatë tërë procesit të monitorimit të aktiviteteve të prokurimit në komunat e tyre përkatëse. Punëtoritë janë ofruar për organizatat lokale nga shtatë rajonet e Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Gjiilan dhe Ferizaj.



Foto 31: Prezantimi i raportit nga organizatat lokale të rajonit të Prizrenit në monitorim të aktiviteteve të prokurimit publik



Foto 32: Punëtori e organizatave lokale në rajonin e Pejës për monitorim të aktiviteteve të prokurimit publik



## 5.1.2 Infografikat e publikuara nga organizatat përfituese

Gjatë muajit shkurt dhe mars, organizatat e shoqërisë civile kanë publikuar raportet e të gjeturave në formë të infografikave për kontratat të cilat i kanë monitoruar në komuna e tyre. Të gjeturat e publikuara nga organizatat përfituese ishin këto:

Foto 33: Raporet e organizatave të shoqërisë civile të publikuar në Infografikat





### 5.1.3 Ngritja e kapaciteteve të organizatave nga rajoni i veriut në monitorim të prokurimit publik

Gjatë muajit gusht 2021, Platforma CiviKos në kuadër të USAID TEAM, ka ofruar trajnimin dy-ditor për organizatat e shoqërisë civile nga Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviq dhe Zubin Potok. Trajnimi dhe materialet e shpërndara janë fokusuar rreth monitorim të prokurimit publik në nivel lokal si dhe bashkëpunimin me media në ekspozim të parregullsive në procesin e prokurimit.



Foto 34: Gjatë trajnimit për organizatat e shoqërisë civile nga Mitrovica Veriore

### 5.1.4 Platforma Monitoro-Raporto [www.monitoro-raporto.net](http://www.monitoro-raporto.net)

Më 9 qershor, Platforma CiviKos në kuadër të USAID TEAM, përmes një eventit hibrid ka lansuar platformën Monitoro-Raporto. Kjo platformë e zhvilluar nga CiviKos, ka për qëllim që të shërbej si pikë qendrore për organizatat e nivelit lokal, si dhe për të gjithë ata që janë duke punuar në mënyrë aktive në monitorim të prokurimit publik apo synojnë të punojnë në të ardhmen. Monitoro-Raporto do të jetë një hapësirë e përbashkët për organizata lokale që të publikojnë raportet e tyre, të gjejnë materiale relevante për monitorim të prokurimit publik, si dhe të ofroj mundësi rrjetëzimi me organizata të ndryshme.





Foto 35: Prezantimi i platformës Monitoro-Raporto

### 5.1.5 Njohja e kompetencës në monitorim të prokurimit publik

Platforma CiviKos përmbylli bashkëpunimin katër-vjeçar me aktivitetin e USAID për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse me një ceremoni certifikimi. Të pajisur me certifikata të njohjes së kompetencës në monitorim të prokurimit publik ishin të gjithë përfaqësuesit e organizatave lokale që kishin përfituar nga punëtoritë mbi mësimin e aplikueshëm në monitorim të prokurimit publik. Por, përveç tyre, mundësia certifikimi iu është ofruar edhe përfaqësues të tjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe individ nga të gjitha rajonet e Kosovës, të cilit kanë shprehur interesim për të përfituar nga procesi i certifikimit për njohje të kompetencës në monitorim të prokurimit publik. Për këta të fundit, është mundësuar trajnimi një ditë me dhe i janë nënshtruar procesit të testimit para certifikimit.

Shpërndarja e certifikatave u bë nga znj. Aferdita Mekuli, Drejtore e aktivitetit USAID për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse dhe z. Dardan Kryeziu, Drejtor i Projektit në Platforma CiviKos. Ceremonia është mundësuar të ndiqet edhe virtualisht përmes platformës Zoom për përfituesit që nuk mund të ishin prezent fizikisht.



Foto 36 - 37: Certifikimi për individ nga të gjitha rajonet e Kosovës - Dita 1 dhe 2



Foto 38: Ceremonia e certifikimit

## 5.2 Adresimi i sfidave dhe problemeve të OJQ-ve me bankat komerciale në Kosovë

Edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar bashkëpunimi me European Centre for Not-for-Profit Law (ECNL), për të avokuar rreth sfidave të OJQ-ve në shërbime bankare me institucionet relevante në Kosovë, si Banka Qendrore e Kosovës dhe Shoqata e Bankave në Kosovë.

Me 10 nëntor, CiviKos organizoi takimin e radhës me akterë relevant për qasjen e OJQ-ve në shërbime bankare dhe ndikimin në punën e OJQ-ve. Ky takim mbledhi së bashku përfaqësues nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Shoqata e Bankave të Kosovës, si dhe komunitetin e OJQ-ve për të shkëmbyer përvojat në lidhje me de-rrezikimin bankar dhe gjetjen e zgjidhjeve për të lehtësuar qasjen e OJQ-ve në shërbimet bankare.

Pjesa përmbajtësore e takimit u mbulua nga z. Dren Puka (KCSF), i cili prezantoi ndikimin e barrierave që bankat aplikojnë për OJQ-të në punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, si dhe nevojën për përmirësimin e kornizës ligjore në Kosovë dhe praktikave për lehtësim të qasjes së OJQ-ve në shërbime bankare. Përrashtimi financiar i OJQ-ve është fenomen global dhe mohimi i qasjes në shërbime bankare për shoqërinë civile prek një sërë të drejtash të njeriut.



Foto 39: Ceremonia e certifikimit

## 5.3 Ngritja e kapaciteteve të organizatave lokale mbi avokimin e të drejtave të njeriut

Në shkurt të vitit 2021, CiviKos filloi zbatimin e projektit 'You Cannot Be What you Cannot See', financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) përmes Community Development Fund (CDF).

Ky projekt ka kontribuar në fuqizimin e organizatave të nivelit lokal dhe iniciativave me bazë në komunitet përmes aktiviteteve shumë-dimensionale, të tilla si punëtori mbi mësimin e aplikueshëm në të drejtat e njeriut, sigurimin e mekanizmave të avokimit dhe komunikimit, si dhe mundësive të rrjetëzimit me organizatat tjera që punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut.

### 5.3.1 Punëtoritë për të drejtat e njeriut

Punëtoritë për të drejtat e njeriut janë ofruar në dy seri për organizatat me bazë në komunitet në komunën e Dragashit, Klinës dhe Kamenicës. Këto seri të punëtorive, me trajner z. Hilmi Jashari, kanë mbuluar temat rreth adresimit të shkeljeve të drejtave të njeriut, avokimit, dhe ndërtimit të strategjive të organizatave lokale për promovim të drejtave të njeriut me institucionet lokale.



Foto 40: Punëtoria në Kamenicë



Foto 41: Punëtoria në Dragash



Foto 42: Punëtoria në Klinë



Foto 43: Punëtoria në Klinë

Përmbledhja vizuale e punëtorive në kuadër të projektit të 'You Cannot Be What You Cannot See'



Foto 44: Përmbledhja I



Foto 45: Përmbledhja II

### 5.3.2 Krijimi i Human Rights Hub

Në kuadër të këtij projekti, Platforma CiviKos ka ofruar një hapësirë të veçantë në web faqën e CiviKos duke krijuar Human Rights Hub. Në këtë hapësirë janë ofruar materiale të ndryshme për të drejtat e njeriut dhe e njëjta do të mirëmbahet dhe përditësohet nga CiviKos.

### 5.3.3 Konferenca 'Roli i Shoqërisë Civile në Avokim për të Drejtat e Njeriut'

Më 3 shtator, Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, organizuan një konferencë të përbashkët mbi rolin e shoqërisë civile në promovim dhe avokim të drejtave të njeriut. Kjo konferencë shënoi edhe përfundimin e këtij projekti. Folëse kryesore në këtë



konferencë ishte znj. Emilia Rexhepi, Zëvendëskryeministre e Kosovës, e cila ka një veprimtari politike që përfshinë çështjet e të drejtave të njeriut.

Për shkak të masave kundër COVID-19 në atë kohë, numri i pjesëmarrësve në konferencë ishte i limituar, ndërsa konferenca është organizuar në formatin hibrid për të mundësuar kontributin në diskutim nga të akterët dhe të interesuarit e tjerë.



Foto 46: Konferenca 'Roli i Shoqërisë Civile në Avokim për të Drejtat e Njeriut'

#### 5.4 Bashkëpunimi i CiviKos me International Visegrad Fund

Platforma CiviKos ka organizuar raundin e parë të vizitës studimore nga hulumtuesit dhe ekspertët e Grupit të International Visegrad Fund (V4). Kjo vizitë është mundësuar në kuadër të instrumentit të Bashkëpunimit për Institutet Kërkimore të Ballkanit Perëndimor – THINK BALKANS, mbështetur financiarisht nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit, dhe i zbatuar nga Instituti për Demokraci 'Societas Civilis' - Shkup (IDSCS).

Gjatë këtij raundi vizitash, ekspertë patën mundësi të takohen me zyrtarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës dhe partive politike, dhe zyrtarë të institucioneve të BE-së dhe misionëve të huaja diplomatike në Kosovë.



Foto 47: Hulumtuesit dhe ekspertët e Grupit të International Visegrad Fund (V4), në Prishtinë



## 5.5 Aktivitetet në kuadër të Konferencës për të Ardhmen e Evropës (CoFoE)

### 5.5.1 Fokus grupi

Në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung (FES) dhe organizata të tjera, CiviKos mbledhi përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve për politika evropiane dhe qendrave të Ballkanit Perëndimor, për të diskutuar të ardhmen dhe vizionin e Evropës prej perspektivës të Ballkanit Perëndimor në formatin e fokus grupit. Pjesëmarrësit ndanë mendimin e tyre në lidhje me shumë tema që lidhen kryesisht me qeverisjen evropiane dhe Ballkanin.

Kjo iniciativë kishte për qëllim përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në kontributin dhe reflektimin e të ardhmes të Evropës, inputet e të cilës u përfshin në raportin e Ballkanit Perëndimor që përgatiti FES e do të prezantohej në Bruksel, Paris dhe Vjenë.



Foto 48: Fokus grupi në Prishtinë

### 5.5.2 Konferenca

Të dhënat nga fokus grupi paraprak dhe bashkëpunimi i partnerëve që mundësuan atë, u shtjelluan më gjerësisht në konferencën 'Ballkani Perëndimor Diskuton për të Ardhmen e Evropës', organizuar nga CiviKos. Diskutimi u hup nga Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Tomas Szunyog.



Foto 49: Konferenca 'Ballkani Perëndimor Diskuton për të Ardhmen e Evropës'

## 5.6 Diskutim me Simon Panek, themelues i People in Need

Platforma CiviKos dhe People in Need Kosovo (PIN), organizuan një diskutim me z. Simon Panek, shefi ekzekutiv dhe bashkë-themeluesi i People in Need. Z. Panek ka ndarë me të pranishmit përvojën e tij personale nga aktivizmi shumëvjeçar dhe përshtypjet e tij lidhur me rëndësinë e vendosmërisë në arritjen e misionit dhe përfaqësimit të komunitetit për OJQ-të.



Foto 50: Gjatë diskutimit me z.Simon Panek



